



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 240, Datë 24.08.2026

MBI

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 238,  
DATË 06.11.2024 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ORHER” SH.P.K. NË  
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.08.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 998/10 prot., datë 21.08.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 238, datë 06.11.2024 “Mbi licencimin e shoqërisë “ORHER” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, i ndryshuar”,

**Konstatoi se:**

**1. Të dhëna mbi shoqërinë “ORHER” sh.p.k.**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 238, datë 06.11.2024, i ndryshuar me vendimin nr. 150, datë 28.05.2026, vendosi të licencojë shoqërinë “ORHER” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 MW, në zonën e Semanit, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.
- Në pikën 3 të këtij vendimi përcaktohet se shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës brenda datës 22.07.2026.

**2. Analiza ligjore dhe vlerësimi**

- Për vendimin nr. 150/2026 shoqëria është njoftuar me shkresën e ERE-s me nr. 998/7 prot., datë 02.06.2026, me anë të së cilës i është sjellë në vëmendje detyrimi për të depozituar brenda datës 22.07.2026 testimin e veprës. Për këtë detyrim, ERE e ka rikujtuar shoqërinë nëpërmjet shkresës me nr. 998/8 prot., datë 17.07.2026.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 998/9 prot., datë 10.08.2026, shoqëria ka depozituar pranë ERE-s Raportin e Testimit të veprës, të kryer nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), me nr. 1609/6 prot., datë 04.08.2026, nga ku rezulton se kontrolli dhe verifikimi janë kryer më 20.05.2026 nga Grupi i Punës i AKBN-së dhe nga i cili është arritur në përfundimin se impianti është në prodhim dhe prodhon brenda kapacitetit të instaluar.
- Rezulton se testi i veprës është kryer në datën 20.05.2026, pra brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 238/2024, i ndryshuar. Raporti që dokumenton kryerjen e testimit është hartuar nga AKBN me nr. 1609/6 prot., datë 04.08.2026, dhe është depozituar në ERE nga shoqëria në datën 10.08.2026. Për rrjedhojë, ndonëse dokumentimi në ERE është kryer pas afatit të përcaktuar në pikën 3 të vendimit, vetë testi i veprës rezulton

të jetë kryer brenda këtij afati. Në këto kushte, duke qenë se qëllimi i detyrimit të përcaktuar në pikën 3 është verifikimi i vënies në prodhim dhe funksionimit të implantit brenda afatit të përcaktuar, vlerësohet se vijimi i efekteve të kësaj pike nuk është më i nevojshëm.

### 3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, parashikohet se një akt administrativ mund të anulohet ose shfuqizohet, kryesisht, nga organi publik që ka kompetencë për nxjerrjen e tij, ndërsa anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon ose plotëson aktin e parë.
- Në vijim të shfuqizimit të pikës 3 të vendimit nr. 238/2024, i ndryshuar, vlerësohet i nevojshëm edhe ndryshimi i pikës 4 të këtij vendimi, i cili përcakton se ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, duke e riformuluar si vijon: *“Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të paraqitjes së provave të reja ose konstatimit të gabimeve materiale, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat procedurale të ERE-s.”*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### Vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e bordit të ERE-s nr. 238, datë 06.11.2024, i ndryshuar, si vijon:
  - a) Pika 3 e vendimi të bordit nr. 238, datë 06.11.2024, i ndryshuar, shfuqizohet.
  - b) Pika 4 ndryshon dhe bëhet si më poshtë:
    4. *“Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të paraqitjes së provave të reja ose konstatimit të gabimeve materiale, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat procedurale të ERE-s.*
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “ORHER” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” (ALPEX) sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**